



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 28.9.2020, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Time Kadrijaj, Fitore Pacolli, Fatmire Kollçaku, Kujtim Shala, Arben Gashi, Ariana Musliu-Shoshi dhe Fidan Brina-Jilta.

Munguan: Branislav Nikoliq, Gazmend Gjyshinca dhe Enver Hoxhaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Arta Berisha, GP-LVV dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Time Kadrijaj, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 17 qershor, 15 e 28 korrik dhe 22 shtator 2020;**
3. **Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 07-P-065;**
4. **Shqyrtimi i draft - Planit të Punës së Komisionit;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Fitore Pacolli-Dalipi kërkoi që në rend dite të futet edhe pika “Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës”.

Time Kadrijaj konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës me propozimin e deputetes Fitore Pacolli-Dalipi, si pikë e 5 e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 17 qershor, 15 e 28 korrik dhe 22 shtator 2020

Time Kadrijaj, konstatoi se komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 17 qershor, 15 e 28 korrik dhe 22 shtator 2020.

3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 07-P-065;

Time Kadrijaj njoftoi anëtarët e komisionit se sipas Përfundimit të Kryesisë nr. 07-P-065, kërkohet nga komisionet parlamentare të Kuvendit, përveç Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që mbi bazën e Vendimit të Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, datë 3 qershor 2020, t'i paraqesin Kryesisë së Kuvendit propozimet për harmonizimin e emërtimeve dhe fushëveprimeve të komisioneve, të cilat me pas do të procedohen për miratim në seancë plenare.

Ajo tha se përfundimi i Kryesisë ka të bëjë me fushëveprimtaritë e atyre komisioneve, të cilat kanë pësuar ndryshime me rastin e formimit të qeverisë së re, më 3 qershor 2020, ndërsa komisioni ynë nuk ka pasur ndonjë ndryshim në emërtimin ose fushëveprimtarinë e tij.

Komisioni, sipas pikës 4 të vendimit të seancës plenare nr. 07-V-008 të datës 13.02.2020, në mbledhjen e mbajtur më 25.02.2020 e ka plotësuar fushëveprimin e tij edhe me çështjet e diasporës.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nuk ka pësuar ndonjë ndryshim në emërtimin apo fushëveprimin e tij, me rastin e formimit të qeverisë së re më 3 qershor 2020.

4. Shqyrtimi i draft - Planit të Punës së Komisionit

Time Kadrijaj tha se në planin e punës së komisionit për vitin 2020 janë të përfshira projektligjet, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, raportimi i ministrave dhe çështje të tjera nga fushëveprimi i komisionit.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Vendim

Miratohet Plani i Punës së Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë për vitin 2020.

5. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës

Time Kadrijaj theksoi se në njërin nga mbledhjet e kaluara, komisioni ka vendosur për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. Për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji ajo tha se duhet propozuar anëtarët dhe kryesuesin e grupit punues.

Anëtarët e komisionit diskutuan lidhur me formimin e grupit punues për mbikëqyrjen e ligjit, si dhe kryesuesin e këtij grupi.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Vendim

Formohet grupit i punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me përbërje nga të gjithë anëtarët e Komisionit, si dhe kryesuar nga kryetarja e komisionit znj. Time Kadrijaj.

6. Të ndryshme

Time Kadrijaj njoftoi për kërkesën e anëtarëve komisionit nga radha e GP-LVV, sipas së cilës kërkohet që Kryeministri Hoti të raportojë në komision lidhur me takimin në Uashington më 4 shtator 2020.

Lidhur me këtë kërkesë, komisioni pas votimit vendosi që Kryeministri të mos ftohet për raportim, pasi që kjo çështje është konsumuar në seancën plenare të Kuvendit.

Ariana Musliu-Shoshi tha se është e nevojshme që në mbledhjen e komisionit të ftohet për raportim ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, znj. Meliza Haradinaj-Stublla, por se këtë çështje do ta ngritë në mbledhjen e radhës, ku do t'i propozojë edhe temat për të cilat kërkon që të ftohet ministrja në raportim.

Time Kadrijaj njoftoi anëtarët e komisionit për iniciativën e marr lidhur me organizimin e një vizite zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Ajo tha se është në konsultim me Ambasadorin tonë në Shqipëri dhe se pritet që kjo vizitë e komisionit të realizohet në fund të muajit tetor.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Time Kadrijaj